



NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte më datë 19 janar 2017, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Z. Gentian	SALA	Kryetar
Z. Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Z.Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Z.Gledis	GJIPALI	Anëtar
Z.Piro	MISHA	Anëtar
Znj.Suela	MUSTA	Anëtar
Z.Zylyftar	BREGU	Anëtar

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, miratoi vendimet e mëposhtme:

1. Miratimin e një ndryshim në vendimin e AMA-s nr. 5, datë 22.05.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim”, i ndryshuar”, **(Vendim nr. 01, datë 19.01.2017)**
2. Shqyrtimin e ankimit të shoqërisë “ADTN” sh.a mbi revokimin e vendimit nr.286, datë 29.12.2016 të AMA dhe shqyrtimin e aplikimit për dhënie licence kombëtare të transmetimit audioviziv. Miratimin e revokimit të vendimit nr.286, datë 29.12.2016 të AMA. Rëzimin e aplikimit për dhënie licence kombëtare të transmetimit audioviziv, në dy votime dhe shtyrjen e vendimmarrjes në mbledhjen e radhës.
3. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Abidin Fraholli, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Fraholli” **(Vendim nr. 02, datë 19.01.2017)**
4. Shqyrtimin e aplikimit të paraqitur nga shoqëria “I.B.C.” sh.p.k për marrjen e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (OTT) “I.B.C- TELECOM” **(Vendim nr. 03, datë 19.01.2017)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

5. Shqyrtimin e aplikimit të paraqitur nga shoqëria “Cable Net” sh.p.k për marrjen e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Cable Net”. **(Vendim nr. 04, datë 19.01.2017)**

Në këtë mbledhje të AMA u paraqit dhe prezantimi nga Ekspertë të Këshillit të Europës mbi “Elaborimin e çështjeve të anti-diskriminimit nga optika e roli i AMA dhe roli i medias audiovizuale në luftën kundër diskriminimit” në kuadër të projektit të Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian “Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit”

Tiranë, 19 Janar 2017

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE